



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
REKTORI

Nr. 2278 Prot.

Tiranë, më 10 . 10 .2025

UDHËZIM

Nr. 7 datë 10 . 10 .2025

**“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË INTEGRUAR TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE, RAUNDI III, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, VITI AKADEMIK 2025-2026”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimit të MAS nr. 12, datë 30.06.2023 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë publike”, i ndryshuar; Urdhrit të Përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 të QSHA dhe RASH, “Për miratimin e kalendarit të zhvillimit të procesit të aplikimit, pranimi dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026”, lidhur me procesin e aplikimit dhe regjistrimit në kuadër të plotësimit të kuotave të mbetura bosh në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë, Raundi III,

UDHËZOJ:

1. Kandidatët që janë pjesë e portalit U-Albania dhe që rezultojnë të pa regjistruar në një program studimi, aplikojnë pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore (fakultetit) përkatëse, në datat **13 dhe 16 tetor 2025**, nga ora **8:00 deri në 14:00**.
2. Kandidatët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:
  - a) Kërkesën me shkrim për aplikim në atë program studimi (sipas modelit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
  - b) Kopje të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën përkatëse të notave (për të gjitha vitet e shkollës së mesme);
  - c) Kopje të dokumentit të identifikimit.
3. Njësitë kryesore brenda datës **16 tetor 2025** përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve. Publikimi i listave të kandidatëve sipas renditjes bëhet me datë **17 tetor 2025** në faqen zyrtare të njësisë kryesore përkatëse dhe të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

4. Me datë **20 dhe 21 tetor 2025**, bëhet regjistrimi i kandidatëve sipas renditjes së shpallur në pikën 3, pranë njësive kryesore në përputhje me kuotat e mbetura bosh, si më poshtë:

**Data 20 tetor 2025**

*Faza I – ora 9.<sup>00</sup>-11.<sup>00</sup>*  
*Faza II – ora 11.<sup>01</sup>-13.<sup>00</sup>*  
*Faza III- ora 13.<sup>01</sup>-15.<sup>00</sup>*  
*Faza IV- ora 15.<sup>01</sup>-17.<sup>00</sup>*

**Data 21 tetor 2025**

*Faza I – ora 9.<sup>00</sup>-11.<sup>00</sup>*  
*Faza II – ora 11.<sup>01</sup>-13.<sup>00</sup>*  
*Faza III- ora 13.<sup>01</sup>-15.<sup>00</sup>*  
*Faza IV- ora 15.<sup>01</sup>-17.<sup>00</sup>*

5. Kandidati fitues ka të drejtë të **regjistrohet brenda minifazës 2 orëshe**, në të kundërt vendi fitues i kalon kandidatëve në pritje sipas listës së renditur.
6. Njësitë kryesore përcjellin në Rektorat listat e kandidatëve të regjistruar brenda datës **22 tetor 2025**.
7. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen njësitë kryesore të UMT-së dhe sekretaritë mësimore.

**REKTORI**  
**Prof. Dr. Xheladin DRAÇINI**



## Shtojca nr. 1

### FORMULAR KËRKESË

Unë e/i nënshkruara/i, \_\_\_\_\_, ID e maturës \_\_\_\_\_, aplikant pjesë e portalit U-Albania, paraqes kërkesën time për të vijuar konkurrimin në programin e studimit \_\_\_\_\_.

- Deklaroj se nuk jam regjistruar në asnjë program tjetër studimi.
- Jam informuar nëpërmjet faqes zyrtare të njësisë kryesore (fakulteti) dhe universitetit, për udhëzimin e Rektorit të UMT-së nr. 7, datë 10.10.2025 "*Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të integruar të ciklit të dytë të studimeve, Raundi III, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, viti akademik 2025-2026*" lidhur me publikimin e renditjes dhe fazat e regjistrimit të kandidatëve.

---

Emër

Atësi

Mbiemër

Nr. telefoni: